

Formulari Nr.3

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: QENDRA KULTURORE E FEMIJEVE DURRES
Adresa: L.3 RR.AT ERAZMI DURRES
Tel/Fax: 052 223059
E-mail: qkfdurres@yahoo.com
Faqja në Internet _____

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: Bileta vajtje – ardhje Tirane – Kiev - Tirane.

Data e zhvillimit do të jetë 03.08.2021, ora 11:30 në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

Bileta udhëtimi vajtje – ardhje Tirane - Kiev - Tirane (bileta)	15 bileta (sasia dhe njësia)
--	---------------------------------

Nisja në dt 18 Gusht 2021 me destinacion Tiranë – Kiev.
Kthimi në dt 25 Gusht 2021 me destinacion Kiev – Tiranë.

Bagazhi për person të jete: bagazh dore + 20 kg për vajtje – ardhje.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentat si më poshtë:

- a) Rezervimin e biletave, sipas destinacionit të kërkuar
- b) Ofertuesi ekonomik duhet të realizojë check – in online për vajtje dhe kthim;
- c) Operatori ofertues duhet të ketë si objekt veprimtarie të deklaruar në QKB “ Agjensi Udhëtimesh”, si dhe nuk duhet të jetë në proces falimentimi (status aktiv), nuk duhet të jetë dënuar për shkelje penale në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, nuk duhet të jetë dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale . (Ofertuesi të plotësojë Vet – deklaratën bashkëlidhur)
- d) Operatori Ekonomik duhet të ketë Certifikatë Akreditimi ose një Vërtetim nga IATA (Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror)
- e) Ofertuesi fitues duhet të paraqesë ekstraktin e QKB dhe vërtetim bankar (IBAN).
- f) Ofertuesi fitues duhet të jete i pajisur me fature të njohur sipas legjislacionit tatimor.

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për realizimin/mosrealizimin e objektit të prokurimit, brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit në sistem, në të kundërt do të s'kualifikohet duke përzgjedhur ofertuesin ekonomik të renditur në vendin e dytë ,e kështu me radhë deri në ofertuesin e dhjetë.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ
TIJ**

Avni Çuni
(emri, mbiemri, firma, vula)